

5909

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 5909

V E N D I M
PER REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me date 24.08.1994 une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, Anila Capo, si shqyrtova kerkesen e kerkuesit Perparim Markja, i cili kerkon regjistrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MARKJA MARINI" si person juridik ;

K O N S T A T O V A :

Kerkuesi kerkon regjistrimin si person juridik te e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MARKJA MARINI" SHPK me seli ne Peshkopi, me ortak e administrator te vetem kerkuesin Perparim Markja, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me kapital 100.000 leke dhe me objekt te veprimtarise se saj ne fushen e import eksport tregtim karburanti, vajra lubrifikante, derivate te naftes, me shumice e pakice, pjese kembimi per makineri dhe automjete te ndryshme, tregtim mallrave te ndryshme ushqimore dhe industriale.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE:

Ne baze te ligjit nr.7638, date 10.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.7667, date 23.01.1993 "Per regjistrin tregtar"

V E N D O S A :

Regjistrimin si person juridik te e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MARKJA MARINI" SHPK me seli ne Peshkopi, me ortak e administrator te vetem kerkuesin Perparim Markja, me kohezgjatje mbi 10 vjet, me kapital 100.000 leke dhe me objekt te veprimtarise se saj ne fushen e import eksport tregtim karburanti, vajra lubrifikante, derivate te naftes, me shumice e pakice, pjese kembimi per makineri dhe automjete te ndryshme, tregtim mallrave te ndryshme ushqimore dhe industriale.

Kunder vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte.

G J Y Q T A R E
/ Anila Capo /





AKT THEMELIMI

I SHOQERISE "MARKJA MARINI" SH.P.K.

I nenshkruari Perparim Markja, i biri i Hysenit, dtl. 1952, lindur ne Puke dhe banues ne Peshkopi, lagjja e re, rruga Nazmi Rushiti , me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise,

V E N D O S A :

- Krijimin e shoqerise "MARKJA MARINI" shpk e cila ka objekt te saj ne fushen e import eksport tregtim karburanti,vajra lubrifikante, derivate te naftes, me shumice e pakice, pjese kembimi per makineri dhe automjete te ndryshme,tregtim mallrave te ndryshme ushqimore dhe industriale.

- Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.

- Administrator i shoqerise eshte Perparim Markja, i biri i Hysenit, dtl. 1952, lindur ne Puke dhe banues ne Peshkopi, lagjja e re, rruga Nazmi Rushiti .

- Qendra e shoqerise eshte ne Peshkopi, lagjja e re, rruga Nazmi Rushiti.

- Jetegjatesia e shoqerise eshte mbi 10 vjet.

ORTAKU I VETEM

/ PERPARIM MARKJA /

S T A T U T



I SHOQERISE "MARKJA MARINI" SH.P.K.

KAPITALI THEMELTAR : 100.000 leke
ORTAKU I VETEM : PERPARIM MARKJA

KREU I

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, QENDRA, JETEGJATESIA

NENI 1

Ne baze te ligjit nr.7512, date 10.08.1991 " Per sanksionimin e mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarive private, te pavarura dhe privatizimit" dhe ligjes nr. 7638, date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare" ortaku i vetem PERPARIM MARKJA, me vullnetin e tij te lire krijon shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "MARKJA MARINI" shpk,

Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar. Ajo eshte person juridik shqiptar dhe zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe normat e akteve te saj themeluese.

Shoqeria pergjigjet perpara te treteve me kapitalin e saj themeltar, deri ne kufi te ketij te fundit.

NENI 2

Shoqeria ka objekt te veprimtarise se saj ne fushen e e import eksport tregtim karburanti, vajra lubrifikante, derivate te naftes, me shumice e pakice, pjese kembimi per makineri dhe automjete te ndryshme, tregtim mallrave te ndryshme ushqimore dhe industriale.

Shoqeria e ka qendren ne Peshkopi, lagjja e re, rruga Nazmi Rushiti.

Me vendimin e saj shoqeria mund te krijoje qendra dytesore, si filiale, agjenci apo perfaqesi.

NENI 4

Jetegjatesia e shoqerise eshte mbi 10 vjet.

Me vendim te ortakut te vetem apo kur verifikohen rrethana te tilla, kur shperndarja e shoqerise urdherohet shprehimisht nga ligja, shoqeria mund te shperndarhet perpara ketij afati.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqreise eshte 100.000 leke.

Ai i perket teresisht ortakut te vetem, eshte nenshkruar e shlyer prej teresisht ne para.

Me vendim te ortakut te vetem, i cili reegjistrohet ne Librin e Shoqerise, kapitali mund te ndryshohet.

Kapitali themeltar i shoqerise nuk mund te perfaqesohet ne letra me vlere te tregtueshme apo sherbime.

NENI 6

Kapitali themeltar eshte i ndare ne kuota nga 1000 leke secila. Per transferimin e tyre ne cdo forme apo tek cdo subjekt kompetent eshte ortaku i vetem.

NENI 7

Shoqeria ka te drejte te lere peng nje pjese te kapitalit te saj themeltar. Ne rast shitje te detyruar te pjeseve te lena peng, pengmarresi do te pranohet si person te cilit i jane transferuar pjese te kapitalit themeltar me perjashtim te rasteve kur shoqeria preferon t'i ribleje keto pjese e te deklarroje zvogelimin e mundshem te kapitalit te saj themeltar.



KREU III

ORGANET E SHOQERISE, ADMINISTRIMI

NENI 8

Ortaku i vetem eshte organi me i larte i shoqerise. Atij i takojne kompetencat qe ne ligjen "Per shoqerite trgtare" i jane dhene Asamblese se Ortakeve.

Vendimet e ortakut te vetem regjistrohen ne Librin e Shoqerise.

Neni 9

Cdo i interesuar mund te kerkoje ne Gjykatën e Rrethit Tirane anullimin e vendimeve te ortakut te vetem te marra ne kundërshtim me dispozitat ligjore dhe normat e ketij statuti.

NENI 10

Shoqeria administrohet nga nje administrator i cili eshte Perparim Markja, i biri i Hysenit, dtl. 1952, lindur ne Puke dhe banues ne Peshkopi, rruga Nazmi Rushiti.

NENI 11

Administratori ka te drejte te kryeje cdo veprim administrimi ne interes te shoqerise, brenda objektit te saj te veprimtarise.

NENI 12

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit edhe kur keto nuk perfshihen ne objektin e veprimtarise se shoqerise, apo kur te tretet ne rrethana te caktuara nuk mund ta injoronin kete fakt.

NENI 13

Administratorit i takon firma dhe perfaqesimi i shoqerise.

ADMINISTRATORI I SHOQERISE
Përparim Markja

K E R K E S E



5909

KERKUESI ; Perparim Markja, i biri i Hysenit, dtl. 1952, lindur ne Puke dhe banues ne Peshkopi, lagjja e re, rruga Nazmi Rushiti , me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise,



OBJEKTI : Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MARKJA-MARINI" shpk

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Vendosa krijimin e shoqerise "MARKJA-MARINI" shpk e cila ka objekt te veprimtarise se saj ne fushen e import eksport tregtim karburanti, vajra lubrifikante, derivate te naftes, me shumice e pakice, pjese kembimi per makineri dhe automjete te ndryshme, tregtim mallrave te ndryshme ushqimore dhe industriale.

- Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë.
- Administrator i shoqerise eshte Perparim Markja, i biri i dtl. 1952, lindur ne Puke dhe banues ne Peshkopi.
- Qendra e shoqerise eshte ne Peshkopi
- Jetegjatesia e shoqerise eshte mbi 10 vjet.

Duke pasur te gjitha dokumentacionin e nevojshem kerkoj ta regjistroj kete shoqeri si person juridik prane Regjistrin Tregtar ne kete gjykate.

ORTAKU I VETEM

/ Perparim Markja /

60
Kerkesa
24.08.84
Perparim Markja

E.B

GJYKATA:

TIRANE

NR. Vendimit:

5909

Data Vendimit:

24.8.1994

Adresa:

PESHKOPI

Lloji i Biznesit

SHPK

SHA

Administratori:

PERPARIM

MARKIA

Admin te tjere

PO

Jo

Emri i Kompanise:

MARKIA MARINI